





**MILLENNIUM
FOUNDATION
KOSOVO**



Memorandum Mirëkuptimi

ndërmjet

Fondacionit të Mijëvjeçarit të Kosovës

dhe

Komunës së Gjakovës

për

Rinovimet për Eficiencë në Ndërtesa Shumë-Banesore (AER)

Data: 22 korrik 2021

Ky Memorandum i Mirëkuptimit ("MM") lidhet nga dhe ndërmjet:

1. **Fondacionit të Mijëvjeçarit të Kosovës ("MFK")**, fondacion vendor i organizuar dhe regjistruar në përputhje me Marrëveshjen për Grant të Programit Threshold të Sfidës së Mijëvjeçarit ("**Marrëveshja**"), nënshkruar dhe ratifikuar më 12 shtator 2017, ndërmjet Republikës së Kosovës, të përfaqësuar nga Presidenti i Republikës së Kosovës ("**Qeveria**"), dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të përfaqësuar nga Korporata e Sfidës së Mijëvjeçarit ("**MCC**");

dhe

2. **Komunës së Gjakovës ("Komuna").**

Palët në vijim, ndarazi referohen si "MFK", si "Komuna", dhe së bashku referohen si "Pjesëmarrës" në këtë MM.

I. Përkufizimet

Në këtë MM, shprehjet e mëposhtme kanë këto kuptime:

- **AER** - Rinovimet për Eficiencë në Ndërtesa Shumë-Banesore
- **Kontraktor** – Kompani që merret me punët ndërtimore, e përzgjedhur nga MFK-ja përmes procedurës së tenderimit
- **DAED** – Plani i Detajuar Arkitektonik dhe Inxhinierik
- **DSC** – Kompania për projektim dhe mbikëqyrje, e përzgjedhur nga Konsulenti Zbatues
- **EE** – Eficienca e Energjisë
- **IC** – Konsulenti zbatues i PIEE
- **MAB** – Ndërtesat banesore për shumë familje
- **MCC** – Korporata e Sfidës së Mijëvjeçarit
- **MFK** – Fondacioni i Mijëvjeçarit të Kosovës
- **PIEE** - Pilot Stimujt për Eficiencë të Energjisë
- **RELP** – Projekti "Peizazhi i Energjisë së Besueshme"
- **SEEK** – Subvencionet për Eficiencën e Energjisë në Kosovë
- **Programi Threshold** - nënkupton programin e përshkruar në Marrëveshjen për Grant të Programit Threshold ndërmjet MCC-së dhe Qeverisë së Kosovës më 12 shtator 2017.

II. Historiku

Qeveria e Kosovës ka themeluar MFK-në, si subjekt autonom, me autoritetet e pavarura ligjore për ta mbikëqyrur, menaxhuar dhe zbatuar Programin Threshold, të financuar nga MCC. Programi Threshold, me Republikën e Kosovës, do të sigurojë deri në USD 49 milionë për t'i mbështetur reformat e rëndësishme të politikave për ta përmirësuar furnizimin me energji elektrike përmes promovimit të efijencës së energjisë dhe gjenerimit të energjisë së ripërtëritshme, si dhe për të promovuar qeverisje transparente dhe të përgjegjshme.

REL P synon të zvogëlojë hendekun midis kërkesës dhe furnizimit me energji, duke ulur përdorimin e energjisë përmes pilotimit të investimeve të ekonomive familjare në efijencën e energjisë, kalimin në burime joelektrike të ngrohjes me kosto efektive dhe zvogëlimin e barrierave për hyrjet në treg të prodhuesve të pavarur të energjisë.

Aktiviteti Pilot Stimuj për Efijencën e Energjisë (PIEE)¹ në kuadër të REL P, pritet të kontribuojë drejt objektivit të REL P duke rritur ndërgjegjësimin e konsumatorëve sa i përket masave të kursimit të energjisë dhe përfitimet e tyre, si dhe duke u mundësuar familjeve me të ardhura më të ulëta ta tejkalojnë pamundësinë e pagesës së tyre përmes sigurimit të stimujve.

Aktiviteti i PIEE përbëhet prej tri (3) pakove kryesore të ndërhyrjes (IP): (i) Rinovimet për Efijencë në Shtëpi Individuale (HER); (ii) Rinovimet për Efijencë në Ndërtesa Shumë-Banesore (AER), dhe (iii) Gratë Ndërmarrëse në Energji (WEE). Asistenca teknike për MFK-në, në lidhje me zbatimin e PIEE, sigurohet nga Konsulenti Zbatues ("IC").

Objektivat kryesore të pakos së ndërhyrjes AER janë: të zvogëlohet kërkesa për energji/rrymë elektrike dhe kostot e ndërlidhura në sektorin e banimit; të rritet ndërgjegjësimi i EE në sektorin e banimit; të rritet konkurrenca e tregut të shërbimeve të energjisë në Kosovë; dhe të mbështeten standardet e EE dhe programet stimuluese për zhvillimin e mëtejshëm në ndërtesat banesore për shumë familje (MAB).

Komuna e Gjakovës synon të ndërmarrë hapa proaktivë në strukturimin dhe forcimin e strukturave organizative për t'i përmirësuar masat e EE/BER nën sektorin e banimit me fokus në Rinovimet për Efijencë në Shtëpi Individuale (HER) dhe Rinovimet për Efijencë në Ndërtesa Shumë-Banesore (AER). Komuna dhe Konsulenti Zbatues kanë nënshkruar Memorandumin e Mirëkuptimit (MM) më 5 nëntor 2020 për ta nxitur bashkëpunimin e tyre dhe për të kontribuar në arritjen e objektivave dhe zbatimin e aktiviteteve të planifikuara të PIEE.

PRANDAJ, mbi bazën e besimit të ndërsjellë dhe bashkëpunimit, dhe me qëllim të përcaktimit të mëtejshëm të detajeve të bashkëpunimit në lidhje me zbatimin e nën-projekteve sa i përket AER, Pjesëmarrësit synojnë ta lidhin këtë MM.

III. Qëllimi

Qëllimi i këtij MM është të promovojë bashkëpunimin ndërmjet MFK-së dhe Komunës së Gjakovës për zbatimin e efijencës së energjisë në ndërtesat shumë banesore ("Projekti" sipas këtij MM), si pjesë e projektit më të madh të Peizazhit të Energjisë së Besueshme ("REL P") të zbatuar nga MFK-ja. MFK-ja dhe Komuna kanë shprehur synimin e tyre për ta realizuar

¹ Ribrenduar në fillim të vitit 2020 në SEEK (Subvencionet për Efijencë të Energjisë në Kosovë).

Aktivitetin e Projektit në lidhje me ndërtesat banesore për shumë familje ("MAB"). Duke nënshkruar këtë Memorandum të Mirëkuptimit, Pjesëmarrësit synojnë të ofrojnë mbështetje financiare për MAB-të e përzgjedhura dhe synojnë të lidhin marrëveshje të ndarë që do të përcaktojnë përqindjen e saktë (%) dhe detajet e bashkëfinancimit në lidhje me këtë financim në një fazë të mëvonshme.

IV. Natyra e bashkëpunimit

MFK-ja dhe Komuna synojnë të bashkëpunojnë dhe të ofrojnë mbështetje financiare për ndërhyrje sa i përket AER, për MAB-të e përzgjedhura. Shuma e vlerësuar e mbështetjes financiare që synohet të sigurohet nga MFK-ja dhe Komuna është € 458,668.06. Sa i përket aktiviteteve të planifikuara që do të ndërmerren dhe buxhetit në dispozicion të MFK-së dhe Komunës për nën-projektet e AER-së, Pjesëmarrësit në këtë MM kanë pikëpamje të përbashkëta mbi disa pika lidhur me bashkëpunimin e tyre të ardhshëm për realizimin e nën-projekteve të AER:

- (a) MFK-ja dhe Komuna synojnë të bashkëpunojnë dhe të ofrojnë ndihmë dhe burime të nevojshme për financimin e përbashkët të MAB-ve vijuese, përkatësisht:
 - i. Kompleksi i MAB "*Rilindja*" (dy MAB)
 - ii. Kompleksi i MAB "*Te gjykata*" (dy MAB)
- (b) Komuna synon të sigurojë mbështetje financiare duke bashkëfinancuar 30% të kostove totale të nën-projektit, si dhe tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH), për të gjitha MAB-të e përmendura në pikën e mësipërme a). Komuna synon që të sigurojë pjesën e saj të bashkëfinancimit deri në tremujorin e parë të vitit 2022. Pritet që shumat e sakta të bashkëfinancimit të përcaktohen me marrëveshje të veçantë bashkëfinancimi midis Pjesëmarrësve pasi Kontraktuesi të jetë prokuruar nga MFK-ja.
- (c) Pritet që realizimi i nën-projektit të AER të bazohet në Planin e Detajuar Arkitektonik dhe Inxhinierik (DAED), të përgatitur nga Kompania për projektim dhe mbikëqyrje, e kontraktuar nga Konsulenti Zbatues sipas aktivitetit të PIEE.
- (d) Secili Pjesëmarrës cakton pikën e vetme të kontaktit për këtë Memorandum të Mirëkuptimit dhe për të gjitha aktivitetet pasuese, në mënyrë që të sigurohet komunikim i lehtë gjatë realizimit të nën-projekteve.
- (e) Leja ndërtimore (ose deklarata adekuate që tregon që nuk ka nevojë për leje ndërtimore) pritët të lëshohet nga Komuna, si çështje me prioritet të lartë dhe sa më shpejtë të është e mundur.
- (f) MFK-ja dhe Komuna synojnë t'i parandalojnë faktorët e mundshëm të rrezikut që mund të ndikojnë negativisht në realizimin e nën-projektit dhe aktivitetet e tyre, si dhe të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për ta siguruar realizimin me sukses të aktiviteteve të nën-projektit.

V. Aktivitetet e ndërsjella

MFK-ja dhe Komuna planifikojnë t'i ndjekin aktivitetet e mëposhtme për t'i përmirësuar aftësitë e tyre të bashkëpunimit:

- (a) MFK-ja dhe Komuna pritet të marrin pjesë në ceremoninë e nënshkrimit të këtij MM.
- (b) MFK-ja dhe Komuna synojnë të ofrojnë ndihmën e kërkuar, përfshirë ndarjen e çdo informacioni që është jetik për zbatimin e aktiviteteve të nën-projektit të AER.
- (c) MFK-ja dhe Komuna synojnë të angazhohen në mënyrë proaktive në aktivitetet e përbashkëta të nën-projekteve të AER dhe të monitorojnë zbatimin e aktiviteteve, si dhe të bashkëpunojnë për identifikimin e zgjidhjeve në rast rreziku të dështimit të aktiviteteve.

VI. Komunikimet dhe njoftimet

Për të gjitha qëllimet e këtij MM, MFK-ja dhe Komuna përfaqësohen nga personat që mbajnë ose veprojnë në pozitat e mëposhtme:

Për MFK-në:

Petrit Selimi

Kryeshef Ekzekutiv

Adresa: Rr. Migjeni, nr. 21

Kati 9 i ndërtesës së ish-Bankës së Lubjanës

10000 Prishtinë, Kosovë

E-mail: petrit@millenniumkosovo.org

Tel.: +383 49 507 521

Për Komunën e Gjakovës:

Ardian Gjini

Kryetar i Komunës

Adresa: Rruga Nëna Terezë

50 000, Gjakovë

E-mail: ardian.gjini@rks-gov.net


Tel.: +383 390 321 100

Secili Pjesëmarrës i këtij MM mund të propozojë përfaqësues shtesë të autorizuar për ta përfaqësuar atë Pjesëmarrës për të gjitha qëllimet, përveç për ekzekutimin e ndryshimeve zyrtare në këtë MM. Secili Pjesëmarrës njofton me shkrim Pjesëmarrësin tjetër për ndryshimet në lidhje me përfaqësimin e autorizuar në këtë MM.

VII. Fillimi, modifikimi dhe ndërprerja e këtij MM

Pjesëmarrësit parashikojnë që aktivitetet sipas këtij MM do të fillojnë në datën e nënshkrimit të tij nga Pjesëmarrësit. MFK-ja dhe Komuna mund ta modifikojnë ose ndërpresin me shkrim këtë MM, në çdo kohë.

NË DËSHMI TË KËSAJ, MFK-ja dhe Komuna, secila duke vepruar përmes përfaqësuesit të tyre të autorizuar për këtë MM, kanë nënshkruar këtë MM në dy kopje origjinale, në gjuhën angleze dhe gjuhën shqipe.


petrit Selimi, Kryeshef Ekzekutiv
Fondacioni i Mijëvjeçarit të Kosovës
Data: 22.07.2021


Ardian Gjini, Kryetar i Komunës
Komuna e Gjakovës
Data: 22.07.2021

